

SOLUTION PRO

Frazat e rrezikut: R20/22; R43, R50, R53.
Frazat e sigurisë: S2, S36/37, S46, S60, S61.

Klasa 2, Xn
I DEMSHEM, IRRITUES



N - I DEMSHEM PËR
MJEDISIN

Lënda vepruese:

39.75 % Oksiklorur bakri+4.2 % Cymoxanil

Formulimi: Pluhur i lagshem (WP)

SOLUTION PRO është fungicid me veprim sistemik lokal si dhe kontakti, i cili përdoret në kontrollin e vrugut në hardhi, patate, domate, trangu e perime të tjera. Cymoxanili ka veprim sistemik të lokalizuar dhe të shpejtë, duke penguar mbirjen e sporeve; ndërsa Oksiklorur bakrit ka veprim kontakti dhe të zgjatur.

Përdorimi:

Ne vreshta, për kontrollin e vrugut, duke trajtuar heret, me 250-300 gr/100 lit ujë.

Ne patate, për kontrollin e vrugut, me 2.5-3 kg/ha.

Ne perime, për kontrollin e vrugjeve, me 2.5-3 kg/ha, me volum tretësire 400-600 lit. ujë.

Masat mbrojtëse:

- Mbajeni në vende të sigurta dhe të paarrtshme nga fëmijet.
- Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lekures me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymemarrjes gjatë përgatitjes së solucionit spërkatës dhe gjatë spërkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse dhe mjetet spërkatëse.
- Pas përfundimit të punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.
- Asgjësimi i ambalazheve të bëhet sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e pare dhe këshilla për mjekun

- Në rast kontakti me lekuren ose mukozat lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun.
- Në rast thithjeje të tretësires spërkatëse me organe të frymemarrjes, i aksidentuari çohet në një mjedis të ngrohtë dhe të ajrosur.
- Në rast helmimi kerkoni menjëherë ndihmë në qendrën më të afërt spitalore, duke i treguar mjekut etiketën e këtij produkti.
- Nuk njihet antidoti specifik. Mjekimi sipas simptomave.

Verejtje për përdorimin:

- Përzihet me produktet e tjera, me përjashtim të atyre me reaksion alkalik.
- Nuk duhet të përdoret në kulturat që kanë kaluar stresë nga temperaturat e uletë, ujëtja e tepert, thatësira, etj.
- Nuk përdoret në bimët zbuturuese.

Ndikimi në ekosistem:

- Nuk është helmues ndaj bletëve.
- Është helmues ndaj peshqve dhe organizmave të tjera ujore, prandaj mos ndotni ujrat me këto produkt ose me ambalazhet e tij.

Magazinimi:

- Preparati ruhet në vende të errëta dhe pa lagështi, në temperaturë 0-35°C.

Fitotoksiciteti:

- Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Karenca: 21 ditë tek rrushi dhe qeporet; 7 ditë në domate dhe patate; 5 ditë tek kungulloret.

Antidot specifik nuk njihet, mjekimi simptomologjik.

Fitotoksiciteti: Nuk është fitotoksik në dozat dhe kulturat e rekomanduara.

Përzihet me shumicën e fungicideve dhe insekticideve përveç atyre me reaksion alkalik.

HELMUES PËR PESHQIT DHE ORGANIZMAT UJORE.

Numri dhe data e regjistrimit: **464; 23.7.2012.**

Sasia neto: **25 kg**

Data e prodhimit: **06/2014**

Data e skadencës: **3 vjet**

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: **ZENITH CROP SCIENCES BULGARIA LTD. 58 B, SOLUNSKA STR., APT.1, SOFIA, BULGARIA**

Distributor: **SHEGAJ – AGR shpk**